



REPUBLIKA E SHQIPÉRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE  
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr. 2, Datë 28.07.2020

PËR

**PËR PËRCAKTIMIN E ZONËS ME PËRPARËSI ZHVILLIMIN E TURIZMIT  
DETAR DHE MIRATIMIN E HARTËS SË AKTIVITETEVE**

Në mbështetje të neneve 7, 9, 10 dhe 16 të Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014 “Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, të nenit 9 dhe 28 të Ligjit Nr. 93/2015 “Për Turzimin”, i ndryshuar, të nenit 4 dhe 6 Ligjit Nr. 43/2020 “Për aktivitetet e turizmit detar”, të Vendimit Nr. 686, datë 22.11.2017 të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e Rregullores së Planifikimit të Territorit”, të ndryshuar, të Vendimit Nr. 519, datë 20.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, Vendimit të KKT-së Nr.2, datë 14.06.2016 "Për miratimin e Planit të Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar", me propozim të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit nëpërmjet Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

**VENDOSI:**

1. Përcaktimin e zonës me përparësi zhvillimin e turizmit detar dhe miratimin e hartës së aktiviteteve sipas 60 zonave të interesit:

- 1.1. *Grykëderdhja e Bunës;*
- 1.2. *Velipojë;*
- 1.3. *Laguna e Vilunit;*
- 1.4. *Rrjoll;*
- 1.5. *Rana e Hedhun;*
- 1.6. *Shëngjin-Veri;*
- 1.7. *Shëngjin;*
- 1.8. *Kune-Vain;*
- 1.9. *Tale;*
- 1.10. *Laguna e Patokut;*
- 1.11. *Grykëderdhja e Ishmit;*
- 1.12. *Kepi i Rodonit;*
- 1.13. *Gjiri i Lalzit;*
- 1.14. *Rrushkull;*
- 1.15. *Jube-Sukth;*

- 1.16. *Porto Romano;*
- 1.17. *Currilat;*
- 1.18. *Durrës-Qytet;*
- 1.19. *Durrës-Plazh;*
- 1.20. *Golem;*
- 1.21. *Karpen Zona Ekonomike;*
- 1.22. *Karpen;*
- 1.23. *Kodrat e Karpenit;*
- 1.24. *Spille;*
- 1.25. *Laguna e Karavastasë;*
- 1.26. *Divjakë;*
- 1.27. *Grykëderdhja e Semanit;*
- 1.28. *Darëzezë;*
- 1.29. *Pishë-Poro;*
- 1.30. *Nartë;*
- 1.31. *Zvërnec;*
- 1.32. *Vlorë;*
- 1.33. *Radhimë;*
- 1.34. *Orikum;*
- 1.35. *Pashaliman;*
- 1.36. *Karaburun;*
- 1.37. *Palasë-Drimadhë-Dhërmi;*
- 1.38. *Gjipe;*
- 1.39. *Jal;*
- 1.40. *Gjiri i Akuariumit;*
- 1.41. *Livadh;*
- 1.42. *Livadh-Himarë;*
- 1.43. *Himarë;*
- 1.44. *Llaman;*
- 1.45. *Gadishulli Porto Palermo;*
- 1.46. *Porto Palermo;*
- 1.47. *Qafë Suqe;*
- 1.48. *Qeparo;*
- 1.49. *Borsh;*
- 1.50. *Lukovë;*
- 1.51. *Kakome;*
- 1.52. *Gji 1*
- 1.53. *Gji 2*
- 1.54. *Gji 3;*
- 1.55. *Sarandë;*
- 1.56. *Çukë-Manastir;*
- 1.57. *Manastir-Ksamil;*
- 1.58. *Ksamil;*
- 1.59. *Kepi i Skalës;*
- 1.60. *Konispol;*

*MINISTERI I ZHILLIT*

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi janë:

- Harta e aktiviteteve të turizmit detar;
- Materiali shoqëruesh i Hartës së aktiviteteve të turizmit detar, i cili përmban pasaportat sipas 60 zonave të interesit.

3. Përcaktimi i zonës me përparësi zhvillimin e turizmit detar dhe miratimi i hartës së aktiviteteve bëhet në funksion të:
  - nxitjes së aktiviteteve të turizmit detar që zhvillohen përgjatë vijës bregdetare, hapësirës detare dhe në ujërat e brendshme të Republikës së Shqipërisë të tilla si: *lundrimi përzbavitje; peshkimi turistik; peshkim nën ujë; zhytje çlodhëse; aktivitete të tjera ujore, si kitesurfing, windsurf, ski në ujë, wakeboard, motor uji etj.*
  - nxitjes së turizmit cilësor e të qëndrueshëm duke koordinuar e orientuar investimet publike e nxitur investimet private në keto zona;
  - arritjes së ekuilibrit mes zhvillimit të turizmit dhe mbrojtjes së pasurive natyrore, kulturore dhe historike;
  - menaxhimit të burimeve turistike, ruajtjes së vlerave të vazhdueshme ekonomike, sociale, kulturore dhe mjedisore, me qëllim që ato të mbeten po aq tërheqëse sa më parë dhe të krijohen mundësi për zhvillimin e turizmit në të ardhmen.
4. Gjatë hartimit të planeve sektoriale, planeve të detajuara për zona të rëndësisë kombëtare, planeve sektoriale në nivel qarku, planeve të përgjithshme vendore, projekteve strategjike dhe pilot të zhvillimit, si dhe të tjera të ngjashme me to, autoritetet përgjegjëse të planifikimit dhe të zhvillimit të territorit në nivel qendror, qarku dhe atë vendor, duhet të bazohen në kuadrin referues të detyrueshëm të përcaktuar nga legjislacioni në fuqi dhe nga përcaktimet e këtij vendimi.
5. Ngarkohet Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për kontrollin e përputhshmërisë së dokumenteve të planifikimit, që hartohen nga autoritetet përgjegjëse të planifikimit të territorit me përcaktimet e këtij Vendimi.
6. Ngarkohen Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe gjitha Autoritetet e Planifikimit dhe Zhvillimit të territorit që përfshihen në këto zona për zbatimin e këtij vendimi.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA



MINISTËR I LINJËS

BLENDI KLOSI

MINISTËR I TURIZMIT DHE MJEDISIT



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

LEDIA TOTA

